




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Zyra e Kryetarit



01Nr. 104/01-9920/2019
01/04/2019

Në bazë të nenit 13, 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, nenit 9 të rregullores MF – 02/13 – Për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare për Organizatat Buxhetore, Kryetari i Komunës së Kaçanikut merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR EVIDENTIMIN E SENDEVE QË MUND TË SHFRYTËZOHEN DHE EVIDENTIMIN SENDEVE TË CILAT JANË TË PA PËRDORSHME DHE TË PA VLEFSHME QË GJENDEN NË SHTËPINË E KULTURËS

1. Me këtë vendim formohet komisioni i përkohshëm për evidentimin e sendeve që mund të shfrytëzohen për nevoja të komunës nga materialet që gjenden në shtëpinë e kulturës dhe evidentimin sendeve të cilat janë të pa përdorshme dhe të pavlefshme, me këtë përbërje:
 - a. Muharrem Ahmetaj;
 - b. Filkizare Dema;
 - c. Besnik Dema.
2. Në punën e tyre, anëtarët e komisionit sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të aplikojnë të gjitha procedurat standarde, ashtu siç kërkohen me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë proces dhe në fund të përpilojnë një raport dhe me nga një kopje të njoftohen; Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Auditori i Brendshëm dhe Zyrtari i Pasurisë.
3. Komisioni obligohet që sendeve me vlerë t’iu caktoj çmimin fillestar të cilat më pas do të shiten nëpërmjet ankandit publik dhe sendet që nuk kanë vlere t’i asgjësoj ato.
4. Komisioni obligohet që të organizojë çështjet logjistike si dhe të sigurojë transportin eventual të sendeve.
5. Anëtarët e komisionit duhet ta përfundojnë punën e tyre më së largu deri më 08/04/2019.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk mund të parashtrahet ankesë!

Me këtë vendim te njoftohet:

1. DAK;
2. Anëtarët e Komisionit;
3. Arkivi.





Datë: 04/04/2019
01Nr. 104/02-10363/19

Në mbështetje të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, nenit 7, paragrafi 2, të rregullores MF - Nr. – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, pas raportit të komisionit për vlerësimin e kandidatëve për anëtarë të komisionit vlerësues për projektpropozimet e OJQ-ve, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E APLIKACIONEVE TË OJQ-VE PËR FINANCIM TË PROJEKTEVE APO PROGRAMEVE

1. Me këtë vendim themelohet komisioni komunal për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve për financim të projekteve apo programeve me këtë përbërje:
 - 1.1 **Hasan Zharku**, kryesues;
 - 1.2 **Fatlume Selimi**, anëtare;
 - 1.3 **Arsim Zenuni**, anëtar;
 - 1.4 **Nasrullah Shehu**, anëtar (ekspert i jashtëm i zgjedhur nëpërmjet thirrjes publike);
 - 1.5 **Daut Shehu**, anëtar (ekspert i jashtëm i zgjedhur nëpërmjet thirrjes publike).
2. Me qëllim të shmangies të konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit vlerësues, anëtar rezervë emërohet **Fatmir Qaka**.
3. Detyrat, përgjegjësitë dhe forma e vlerësimit të formularëve të OJQ-ve janë të specifikuara në rregulloren MF - Nr. – 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
4. Komisioni vlerësues, në mbledhjen e tij të parë miraton rregullat e punës, përmes të cilave do të udhëhiqet puna në komision dhe këto rregulla të bëhen publike brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit.
5. Komisioni me përbërje si në piken 1 të këtij vendimi, do të ketë mandat një vjeçar i llogaritur nga data e nënshkrimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Të njoftohen:

Anëtarët e komisionit;

Arkivi.



Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

I	Data	04.04.19	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	
			Shtojcë	
	01 100/01-10455 -1			

Në bazë të nenit 58 pika i. lidhur me nenin 17 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 73, pika 1. Te Statutit të Komunës si dhe Ligjit Nr.06/L-133 per Buxhetin e Republikes se Kosoves per vitin 2019, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Mbi lejin e mjeteve financiare:

I

Në bazë të këtij vendimi lejohet ndarja e mjeteve financiare në vlerë prej: **30,000.00 €** për projektin “Ndertimi i kanalit të ujitjes te Seperacioni, Tregu i kafshëve-Kaçanik”

II

Vlera e mjeteve financiare nga pika 1. e këtij vendimi do te sigurohen nga programi buxhetor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimt Rural, respektivisht nga Kategoria e Investimeve Kapitale te projekti “Projektet zhvillimore per Bujqesi-Blegtori” me kod 86251, fondi burimorë 10

III

Ky vendim hyn ne fuqi në ditën e marrjes.

IV

Për zbatimin e ketij vendimi do te perkujdesen: Zyra e Kryetarit, DBPZHR, drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Zyra e Prokurimit.

V

Me kete vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, DEFZH, dhe DBPZHR.



Besim Ilazi,
Kryetar Komunes së Kaçanikut



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Date	04.04.2019	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
01-104	102-8617	7.	

Zyra e Kryetarit

Në bazë të nenit 13.17 të Ligjit nr.03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe të nenit 61.dhe 73, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kërkesës së pranuar me nr. 104/02-8617/19 e dt. 22.03.2019, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Neni 1.

Me anë të këtij vendimi i lejohet banorëve të Fshatit Kotlinë, që të furnizohet me derivate- naftë deri në 100 litra, me qëllim të realizimit të aktiviteteve të planifikuara - të specifikuar sipas kërkesës së bashkëngjitur të këtij vendimi.

Neni 2.

Për sasinë e lejuar sipas pikes 1. të këtij vendimi banorët e Fshatit Kotlinë, mund të furnizohet me derivate të naftës tek operatori ekonomik, i cili ka kontratë të arritur me K.Kaçanik për furnizim me derivate "Bubeari Petrol" dhe pas furnizimit, obligohet që fletdërgesat në ngarkim ti dorëzoj pranë të Drejtorisë së Administratës Komunale (Zyra e Pranimi të mallrave - faturave) –Kaçanik.

Neni 3.

Me kete vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, dhe Këshilli organizativ i Fshatit Kotlinë.

Bashkëngjitur këtij vendimi:

- Kërkesa: Nr.104/02-8617/19 e dt. 22.03.2019





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01Nr. 352/11-10865/13

Kaçanik, 08.04.2013

Në mbështetje të neneve 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, pas propozimit të drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, kryetari i komunës nxjerr këtë:

VENDIM

Për formimin e grupit punues për hartimin e rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave

- I. Me këtë vendim formohet grupi punues për hartimin e rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave.
- II. Komisioni punues për hartimin e rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Kaçanikut, do të ketë këtë përbërje:
 1. Ramadush Osmani - drejtor i DSHPE -së;
 2. Menduh Krasniqi - shef i sektorit të shërbimeve publike;
 3. Bujar Dullovi - zyrtar për menaxhimin e mbeturinave;
 4. Bujar Bajra - zyrtar për alarmim dhe koordinim emergjent;
 5. Arditë Shehu - zyrtare për mbrojtje të mjedisit;
- III. Komisioni obligohet që menjëherë të filloj punën në hartimin e rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave.
- IV. Komisioni punën e vet, e bën duke patur parasysh nevojat dhe specifikat e komunës së Kaçanikut.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
- VI. Me këtë vendim, njoftohen: Anëtarët e Komisionit dhe Arkivi.



Besim Ilazi

Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Data	12.04.19	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	
	01		40001-11458

Në bazë të nenit 58 pika i. lidhur me nenin 17 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 73, pika 1. Te Statutit të Komunës si dhe Ligjit Nr.06/L-133 per Buxhetin e Republikës se Kosoves per vitin 2019, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Mbi lejimin e mjeteve financiare:

I

Në bazë të këtij vendimi lejohet ndarja e mjeteve financiare në vlerë prej: 15,000.00 € për projektin “Ndertimi i kanalit te ujitjes ne fshatin Rekë-Malësi”

II

Vlera e mjeteve financiare nga pika 1. e këtij vendimi do te sigurohen nga programi buxhetor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimt Rural, respektivisht nga Kategoria e Investimeve Kapitale te projekti “Projektet zhvillimore per Bujqesi-Blegtari” me kod 86251, fondi burimorë 10

III

Ky vendim hyn ne fuqi në ditën e marrjes.

IV

Për zbatimin e ketij vendimi do te perkujdesen: Zyra e Kryetarit, DBPZHR, drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Zyra e Prokurimit.

V

Me kete vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, DEFZH, dhe DBPZHR.



Besim Ilazi,
Kryetar Komunës së Kaçanikut



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipality of Kaçanik

01Nr. 322 / 01-11704 / 19

Në bazë të Ligjit Nr.06/L-133 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, rregullores Nr. Nr.06/2016 nenit 4 paragrafi 1 dhe 2, nenit 7 dhe nenit 8 pika 5, 7, 9 dhe nenit 19, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, në mbështetje të fermerëve, Kryetari i Komunës me rekomandimin e komisionit për vlerësim të kërkesave merr këtë:

VENDIM

PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

1.Me këtë Vendim lejohet ndarja e mjeteve në shumë prej 19,775.00€, për furnizimin e fermerëve përfitues të projektit të serrave (50), me qëllim të realizimit të projektit “Mbështetje e fermerëve me serra me sipërfaqe prej 50m²”.

2. Mbështetja financiare publike për projektet /programet e drejtorisë do të ofrohet nga Buxheti i Komunës, kodi ekonomik 22000 në kuadër të programit subvencione dhe transfere me buxhetin e ndarë për vitin 2019

3.Mjetet e përmendura në nenin 1 do të transferohen në llogarinë rrjedhëse të kompanisë fituese të tenderit, pas përfundimit të ndërtimit të serrave (50), në bazë thirrjes publike për realizimin e projektit të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.

4..Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është: Drejtoria e Financave, Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

5.Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi